



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE  
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**NJOFTIM**

**Për një vend të lirë pune në kategorinë ekzekutive (specialist/e)**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, bazuar në Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për një vend të lirë pune në pozicionin:

**“Specialist/e i/e nivelit të lartë të kërkimeve, studimeve dhe botimeve në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve” - kategoria e pagës IV, klasa e pagës III-3.**

Pozicioni më sipër u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele nga brenda dhe jashtë institucionit të Gjykatës Kushtetuese.

Vetëm në rast se për këtë pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.**

**Përshkrimi i funksioneve kryesore të Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve:**

1. Kërkim ligjor dhe shkencor për çështje të ndryshme ligjore e kushtetuese në shërbim të procesit vendimmarrës, duke evidentuar standardet dhe zhvillimet e fundit të jurisprudencës dhe së drejtës kushtetuese në rrafshin vendas dhe ndërkombëtar, në mbështetje të Njesisë së Shërbimit Ligjor;
2. Ndjekje në aspektin tematik të veprimtarive profesionale, të tilla si konferenca shkencore, vizita shkëmbimi, seminare e trajnime, si dhe kryerje studimesh dhe analizash të herëpashershme e periodike në funksion të rritjes së cilësisë së vendimmarrjes kushtetuese;
3. Studim dhe përpunim indeksik e sistematik i jurisprudencës së Gjykatës, si dhe përgatitje e buletineve, raporteve periodike dhe botimeve të ndryshme të Gjykatës, me qëllim garantimin e qasjes në vendimmarrjen kushtetuese;
4. Administrim i fondit të bibliotekës, si dhe dokumentim, administrim e ruajtje të materialeve me karakter studimor dhe shkencor.

## **Përshkrimi i detyrave që kryen Specialisti/ja i/e Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve:**

Specialisti/ja i/e Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve është përgjegjës/e për:

a) kërkimin ligjor në doktrinën vendase e ndërkombëtare, për evidentimin e praktikave të gjykatave të tjera kushtetuese apo gjykatave ndërkombëtare, lidhur me çështje të ndryshme ligjore e kushtetuese në funksion të procesit vendimmarrës, nën drejtimin e drejtorit të drejtorisë dhe në bashkëpunim të ngushtë me këshilltarin ligjor të çështjes;

b) përgatitjen e studimeve me karakter shkencor, si dhe kryerjen e analizave periodike në përputhje me përparësitë e nevojat e vendimmarrjes dhe veprimtarisë së Gjykatës;

c) renditjen dhe përpunimin e jurisprudencës së Gjykatës, sipas tematikës dhe kriterëve të përcaktuara, si dhe përgatitjen e indeksit alfabetik dhe sistematik për vendimet përfundimtare të Gjykatës;

ç) përgatitjen e përmbledhjeve të vendimeve në funksion të buletinit periodik, raporteve vjetore si dhe udhërrëfyesit të jurisprudencës së Gjykatës, në konsultim me këshilltarët ligjorë;

d) përpilimin e informacioneve dhe kryerjen e studimeve për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, duke evidentuar edhe problematikat përkatëse;

dh) plotësimin e pyetësorëve dhe materialeve të përcjella nga organizmat ndërkombëtarë, në të cilat Gjykata merr pjesë si anëtare me të drejta të plota, në kuadër të organizimit të kongreseve periodike dhe veprimtarive të tjera;

e) zbatimin e masave për ndjekjen në aspektin tematik të konferencave shkencore, seminareve, veprimtarive të tjera që lidhen me kërkimin, studimet dhe publikimet në të drejtën kushtetuese, si dhe veprimtarive që ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve kërkimore institucionale;

ë) përgatitjen e informacioneve që kanë si qëllim përditësimin në kohë të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë me ndryshimet ligjore dhe zhvillimet e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

f) ndihmesën në përgatitjen e komunikimeve të drejtorisë me sektorët e brendshëm të Gjykatës, si dhe me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare analoge në kuadër të marrëdhënieve ndër-institucionale të Gjykatës e në funksion të shkëmbimeve profesionale;

g) kërkimin, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit brenda e jashtë Gjykatës si dhe njohjen e gjyqtarëve dhe këshilltarëve me doktrinën dhe literaturën e re juridike në fushën e jurisprudencës kushtetuese;

gj) zbatimin e kërkesave për përgatitjen e referateve të gjyqtarëve në veprimtari të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit;

h) përgatitjen e relacioneve apo materialeve të tjera me karakter informues lidhur me veprimtarinë e drejtorisë;

i) dokumentimin, administrimin e ruajtjen e të gjitha materialeve me karakter studimor dhe shkencor;

j) kryerjen e çdo detyre tjetër të ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtori i drejtorisë në përputhje me funksionet e drejtorisë.

## **KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për procedurën e pranimi me lëvizje paralele **fillon me datën 28.08.2025 dhe përfundon në datën 09.09.2025.**

### **Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose Shumë mirë”;
- d) Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

### **Kritere të veçanta për pozicionin e “Specialist/e i/e nivelit të lartë të kërkimeve, studimeve dhe botimeve në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve”**

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik DND; DIND ose Bachelor + Master Shkencor në shkencat juridike (*diplomat e lëshuara nga institucione arsimore të huaja duhet të jenë të njësura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*); mesatarja mbi 8, përbën përparësi;
2. Të ketë përvojë pune të ngjashme mbi 3 (tre) vjet;
3. Të ketë njohuri shumë të mira teorike e praktike në përdorimin e kompjuterit, programeve bazë të tij;
4. Të njohë të paktën një nga pesë gjuhët e BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht); njohja e anglishtes si gjuhë e parë e huaj dhe njohja e një gjuhë të dytë nga këto të listuara, përbën përparësi;
5. Të ketë figurë të pastër morale e profesionale dhe të mos jetë i/e dënuar me vendime të formës së prerë të gjykatave;
6. Të mos ketë qenë anëtar/e i/e partive politike për 3 vitet e fundit;
7. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
8. Të mos jetë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore ose shkarkuar nga detyra.

### **Rezultatet e verifikimit paraprak**

Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, brenda datës **11.09.2025**, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, do të renditen në një listë paraprake sipas rendit alfabetik e cila do të **shpallet në datën 12.09.2025**.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për shkaqet e mos kualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual (*nga data 12.09.2025 deri në datën 15.09.2025*) paraqesin ankesat me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit (*deri në datën 20.09.2025*).

### **Dokumentacioni dhe mënyra e dorëzimit**

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Një listë përmbledhëse e të gjithë dokumenteve që dorëzohen, e cila duhet të jetë e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga kandidati.

2. Një kërkesë për aplikim, e cila duhet të përmbajë në formë të përmbledhur kërkesën për punësim në pozicionin e shpallur. Kërkesa në formë të përmbledhur të përmbajë:
  - Lloji i procedurës për të cilën merr pjesë (lëvizje paralele ose pranim në shërbimin civil); emri dhe mbiemri i kandidatit; adresa e saktë e banimit; numri i telefonit dhe celularit; adresa e e-mail-it; data e kërkesës; emri, mbiemri me shkrim dore si dhe nënshkrimi;
3. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip.
4. Fotokopje e diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor në rastin e diplomës master).
5. Lista e notave të diplomës ose krediteve të marra.
6. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
7. Fotokopje e kartës së identitetit (ID).
8. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj të dytë (*në rast se ka*).
9. Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (nga KML).
10. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose formulari i plotësuar që autorizon institucionin për verifikim.
11. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
12. Vlerësimi i punës nga punëdhënësi i fundit.
13. Rekomandime, në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit.
14. Urdhrin ose vendimin e konfirmimit si nëpunës civil.
15. Vërtetimin nga institucioni që ka punuar dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
16. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

#### **Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar:**

Dokumentacionin e kërkuar më lart, kandidati/ja duhet të dorëzojë brenda afatit të caktuar:

- Në protokollin e Gjykatës Kushtetuese ose pranë Drejtorisë Ekonomike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Me postë (*data e postimit me postë të jetë brenda afatit të caktuar për paraqitjen e dokumenteve*).

#### **Fusha e njohurive për kandidatët që do të testohen do të jetë:**

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Ligjin për organizimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese; Rregulloren e brendshme, ligjin për statusin e nëpunësit civil, ligjin për rregullat e etikës në administratën publike, ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, njohuri të përgjithshme për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe njohjen e terminologjisë juridike në përkthimin e materialeve të ndryshme juridikë dhe administrative.

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele (KBLP). Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin e dokumentacionin tjetër të dorëzuar, si dhe për intervistën e strukturuar.

***Intervista do të zhvillohet në mjediset e Gjykatës Kushtetuese në datën 25.09.2025, ora 10:30.***

Mënyra e vlerësimit dhe procedurat që ndiqen për kandidatet është e përcaktuar në dispozitat përkatëse të ligjit si dhe në VKM nr. 243, datë 18.03.2018, i ndryshuar. Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer;

b) 60 pikë intervista me gojë.

### **Mënyra e komunikimit**

Njoftimet dhe komunikimet për çdo fazë të procedurës për kandidatët do të bëhet me e-mail, celular dhe sipas rastit në këndin e informacionit të institucionit dhe në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive".

### **Grafiku i datave të zhvillimit të procedurës me lëvizje paralele:**

|                                                                |                                                               |
|----------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|
| Dorëzimi i dokumenteve:                                        | 28.08.2025 deri më 09.09.2025                                 |
| Shpallja e listës paraprake të kandidatëve të kualifikuar:     | 12.09.2025                                                    |
| Ankimi për kualifikimin paraprak                               | 3 ditë kalendarike nga data e shpalljes                       |
| Zgjidhja e ankimeve për kualifikimin paraprak:                 | deri në 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të ankimit. |
| Shpallja e listës përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar: | 23.09.2025                                                    |
| Intervista e strukturuar me kandidatët e kualifikuar           | 25.09.2025, ora 10:30                                         |
| Njoftimi i vendimit të KBLP nga njësia përgjegjëse             | 29.09.2025                                                    |
| Ankimi për vlerësimin e KPLP-së:                               | 3 ditë kalendarike nga data e shpalljes                       |
| Zgjidhja e ankimeve dhe dhënia e përgjigjes për vlerësimin:    | deri në 3 ditë kalendarike nga data e përfundimit të ankimit  |
| Shpallja e fituesit:                                           | 07.10.2025                                                    |
| Akti i emërimit:                                               | 08.10.2025                                                    |

## KUSHTET PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL

Nëse plotësimi i vendit të lirë në pozicionin “**Specialist/e i/e nivelit të lartë të kërkimeve, studimeve dhe botimeve në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve**” - **kategoria e pagës IV, klasa e pagës III-3**”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton i paplotësuar do të ndiqet procedura për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta dhe ato të përgjithshme të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për procedurën e pranimin në shërbimin civil fillon në datën 28.08.2025 dhe përfundon në datën 15.09.2025.**

**Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- a. Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- b. Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim

**Kritere të veçanta për pozicionin e “Specialist/e i/e nivelit të lartë në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve”:**

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik DND; DIND ose Bachelor + Master Shkencor në shkencat juridike (*diplomat e lëshuara nga institucione arsimore të huaja duhet të jenë të njësura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*); mesatarja mbi 8, përbën përparësi;
2. Të ketë përvojë pune të ngjashme mbi 3 (tre) vjet;
3. Të ketë njohuri shumë të mira teorike e praktike në përdorimin e kompjuterit, programeve bazë të tij;
4. Të njohë të paktën një nga pesë gjuhët e BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht); njohja e anglishtes si gjuhë e parë e huaj dhe njohja e një gjuhë të dytë nga këto të listura, përbën përparësi;
5. Të ketë figurë të pastër morale e profesionale dhe të mos jetë i/e dënuar me vendime të formës së prerë të gjykatave;
6. Të mos ketë qenë anëtar/e i/e partive politike për 3 vitet e fundit;
7. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
8. Të mos jetë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore ose shkarkuar nga detyra.

**Konkurrimi për procedurën e pranimin në shërbimin civil:**

- 1) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- 2) vlerësimin e kandidatëve.

**Rezultatet e verifikimit paraprak:**

Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, brenda datës **24.09.2025**, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, do të renditen në një listë sipas rendit alfabetik, e cila do të publikohet më datën **25.09.2025**.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për shkaqet e moskualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual (nga data 25.09.2025 deri në datën 30.09.2025) paraqesin ankesat me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit (deri në datën 05.09.2025).

### ***Dokumentacioni dhe mënyra e dorëzimit***

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Një listë përmbledhëse e të gjithë dokumenteve që dorëzohen, e cila duhet të jetë e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga kandidati.
2. Një kërkesë për aplikim e cila duhet të përmbajë në formë të përmbledhur kërkesën për punësim në pozicionin e shpallur. Kërkesa në formë të përmbledhur të përmbajë:
  - Lloji i procedurës për të cilën merr pjesë (lëvizje paralele ose pranim në shërbimin civil); emri dhe mbiemri i kandidatit; adresa e saktë e banimit; numri i telefonit dhe celularit; adresa e e-mail-it; data e kërkesës; emri, mbiemri me shkrim dore si dhe nënshkrimi;
3. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip.
4. Fotokopje e diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor në rastin e diplomës master).
5. Lista e notave të diplomës ose krediteve të marra.
6. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
7. Fotokopje e kartës së identitetit (ID).
8. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj.
9. Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (nga KML).
10. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose formulari i plotësuar që autorizon institucionin për verifikim.
11. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
12. Vlerësimi i punës nga punëdhënësi i fundit.
13. Rekomandime në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit.
14. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

### ***Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar:***

Dokumentacionin e kërkuar më lart, kandidati/ja duhet të dorëzojë brenda afatit të caktuar:

- Në protokollin e Gjykatës Kushtetuese ose pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore.
- Me postë (data e postimit me postë të jetë brenda afatit të caktuar për paraqitjen e dokumenteve).

## **Fusha e njohurive për kandidatët që do të testohen do të jetë:**

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Ligjin për organizimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese; Rregulloren e brendshme, ligjin për statusin e nëpunësit civil, ligjin për rregullat e etikës në administratën publike, ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, njohuri të përgjithshme për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe njohjen e terminologjisë juridike në përkthimin e materialeve të ndryshme juridike dhe administrative.

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) Verifikimi paraprak i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët me qëllim për të verifikuar plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) Vlerësimi i kandidatëve.

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën;
- b) Vlerësimi me shkrim;
- c) Intervista e strukturuar me gojë.

Procedurat dhe mënyra e vlerësimit për kandidatët janë përcaktuar në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe në udhëzimet përkatëse të DAP.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) Për vlerësimin e jetëshkrimit (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- b) Për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;
- c) Për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë.

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.

Nëse kandidati grumbullon mbi 45-30 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar.

KPP-ja në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Lista me renditjen e kandidatëve sipas pikëve, i dërgohet nga KKP njësisë përgjegjëse brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga përpilimi i saj.

Kandidatët që kanë marrë më pak se 70 pikë, renditen në një listë të posaçme e cila nuk bëhet publike, dhe ata njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

***Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar do të zhvillohen më datën 09.10.2025, ora 10:30, në mjediset e Gjykatës Kushtetuese.***

## ***Mënyra e komunikimit***

Njoftimet dhe komunikimet për çdo fazë të procedurës për kandidatët do të bëhet me e-mail, celular dhe sipas rastit në këndin e informacionit të institucionit dhe në portalin e "Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive".

## **Grafiku i datave të zhvillimit të procedurës me pranim në shërbim civil:**

|                                                                            |                                                              |
|----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Dorëzimi i dokumenteve:                                                    | 28.08.2025 deri më 15.09.2025                                |
| Shpallja e listës paraprake të kandidatëve të kualifikuar:                 | 25.09.2025                                                   |
| Ankimi për kualifikimin paraprak                                           | 5 ditë kalendarike nga data e shpalljes                      |
| Zgjidhja e ankimeve për kualifikimin paraprak:                             | deri në 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të ankimit |
| Shpallja e listës finale të kandidatëve të kualifikuar:                    | 07.10.2025                                                   |
| Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me kandidatët e kualifikuar | 09.10.2025, ora 10:30                                        |
| Njoftimi i vendimit të KPP nga njësia përgjegjëse                          | 13.10.2025                                                   |
| Ankimi për vlerësimin e KPP-së:                                            | 5 ditë kalendarike nga data e shpalljes                      |
| Zgjidhja e ankimeve dhe dhënia e përgjigjes për vlerësimin:                | deri në 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të ankimit |
| Shpallja e fituesit:                                                       | 27.10.2025                                                   |
| Akti i emërimit:                                                           | 28.10.2025                                                   |

Për më shumë informacion për Gjykatën Kushtetuese dhe veprimtarinë e saj mund të vizitoni edhe faqen tonë në internet: [www.gjykatakushtetuese.gov.al](http://www.gjykatakushtetuese.gov.al)

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni me numrin 0682080345, ose në adresën: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 26, Tiranë.

## **GJYKATA KUSHTETUESE**

Tiranë, më 28.08.2025